



Strasbourg, 15 dhjetor 2015

CPT / Inf (2015) 44

Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruar (KPT)

Hapësira e jetesës për çdo të burgosur në institucionet e burgjeve: Standardet e KPT-së

Standardi minimal i KPT-së për hapësirën personale të jetesës në institucionet e burgjeve është:

- 6m² hapësirë të jetesës për një qeli me një të burgosur të vetëm
+ pajisje sanitare
- 4m² hapësirë jetese për çdo të burgosur në një qeli me shumë të burgosur
+ anekse plotësisht të ndara sanitare
- të paktën 2 metra mes mureve të qelisë
- Të paktën 2.5 metra mes dyshemesë dhe tavanit të qelizës

Hyrje

1. Që nga viti 1990 KPT-ja ka zhvilluar dhe zbatuar standardet minimale lidhur me hapësirën e jetesës që një i burgosur duhet të gëzojë në një qeli. Ndërsa këto standarde janë përdorur shpesh në një numër të madh të raporteve të vizitave të KPT-së, ato deri më tani nuk janë sjellë së bashku në një dokument të vetëm.
2. Në të njëjtën kohë, eshte duke u rritur interesimi për këto standarde, në nivel kombëtar (në mesin e autoriteteve të shteteve anëtare përgjegjëse për pronën e burgut, trupat kombëtare të monitorimit të burgimit si mekanizmat parandalues nacionalë të themeluar sipas OPCAT¹, gjykatat e vendit, OJQ-të, etj) dhe në nivel ndërkombëtar, për shkak të problemit të mbipopullimit të burgjeve dhe pasojave të kësaj. Aktualisht, Këshilli për Bashkëpunim Penologjik i Këshillit të Evropës (PC-CP) është duke përgatitur një Udhezues (Dokument të Bardhë) mbi mbipopullimin e burgjeve. Per me shume, , Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut shpesh thirret për të vendosur mbi ankesat për shkeljen e nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), për shkak të hapësirës së pamjaftueshme të jetesës per nje te burgosur.
3. Përkundrejt kësaj, , KPT-ja ka vendosur në nëntor 2015 të nxjerrë një deklaratë të qartë të pozitës dhe standardeve të veta lidhur me hapësirën minimale të jetesës për çdo të burgosur; i tillë është qëllimi i këtij dokumenti.
4. Qelitë e përmendura në këtë dokument janë qelitë e thjeshta të dizajnuara për strehimin e të burgosurve, si dhe qelitë e veçanta, si ato disiplinuese, të sigurisë, të izolimit dhe të ndarjes. Megjithatë, dhomat e pritjes ose hapësirat e ngjashme që përdoren për periudha shumë të shkurtra kohe nuk shtjellohen ne kete dokument.²

Standardet minimale për hapësirën e jetesës personale në burg: aspektet e përgjithshme

5. Gjatë aktiviteteve të monitorimit, KPT-ja shpesh ka hasur në situata te mbipopullimit në burgje. Pasojat e mbipopullimit janë theksuar dhe përsëritur nga KPT në raportet e veta të vizitave: strehime të ngjeshura dhe të papastra; mungesë e vazhdueshme e privatësisë; aktivitetet të reduktuara jashtë qelive, për shkak të kërkesës që tejkalon personelin e ambientet në dispozicion; shërbimet e stërngarkuara të kujdesit shëndetësor; tensioni i rritur dhe prandaj më shumë dhunë mes të burgosurve dhe ndërmjet të burgosurve dhe personelit. KPT konsideron se çështja e hapësirës minimale të jetesës për të burgosurit lidhet thelbësisht me zotimin e çdo shteti anëtar të Këshillit të Evropës për të respektuar dinjitetin e personave të dërguar në burg.

¹ Protokolli Fakultativ i Konventës Kundër Torturës të Kombeve të Bashkuara

² Çështja e hapësirës se jetesës në vende të tjera ku personat mund të privohen nga liria (stacionet e policisë, institucionet psikiatrike, qendrat e parburgimit, të emigracionit, etj) nuk mbulohen nga ky dokument.

6. Standardet minimale për hapësirë personale të jetesës nuk janë tema aq te thejshta sa mund të duken në shikim të parë. Ne radhe te pare, , standardet e "hapësirës minimale të jetesës" të përdorura nga KPT ndryshojnë sipas llojit të institucionit. Një qeli e policisë për paraburgim afatshkurtër prej disa orësh deri në disa ditë me siguri nuk duhet të përmbushë të njëjtat standarde madhësie si dhoma për pacientë në institucion psikiatrik; dhe një qeli burgu, qoftë për paraburgim ose të burgosur të dënuar, është prapë një çështje krejtësisht e ndryshme.

7. Së dyti, duhet të bëhet një diferencim sipas nivelit të synuar të strehimit në fjalë (d.m.th. nëse është qeli e vetme, ose qeli e projektuar për strehim të shumëfishtë). Termi "strehim i shumëfishtë", gjithashtu duhet të përkufizohet. Një qeli e dyfishtë është pa dyshim e ndryshme nga qelia e projektuar për mbajtjen për shembull të gjashtë ose më shumë të burgosurve. Për sa i përket konvikteve të përmasave të mëdha, që strehojnë dhjetëra e nganjëherë madje edhe deri në njëqind të burgosur,³ KPT-ja ka vërejtje thelbesore që nuk lidhen vetëm me çështjen e hapësirës së jetesës për një të burgosur, por me vete konceptin si të tillë.

Në Raportin e 11-të të Përgjithshëm⁴ KPT-ja kritikoi vetë parimin e strehimit nëpër konvikte të kapacitetit të lartë; shpesh konviktet e tilla i mbajnë të burgosurit në kushte tejet të ngjeshura dhe të pashëndetshme. Përveç mungesës së privatësisë, Komiteti ka gjetur se rreziku i frikësimit dhe dhunës në konvikte të tilla është i lartë, dhe se kontrolli i duhur i stafit është jashtëzakonisht i vështirë. Më tej, shpërndarja e përshtatshme e të burgosurve të veçantë, bazuar në rrezikun për raste individuale dhe vlerësimin e rrezikut dhe të nevojave, bëhet detyrë pothuajse e pamundshme.⁵ KPT-ja rrjedhimisht prej kohësh ka mbrojtur një largim nga konviktet me kapacitete të mëdha drejt njësive më të vogla të jetesës.⁶

8. Së treti, KPT-ja ka marrë parasysh edhe regjimin e ofruar të burgosurve gjatë vlerësimit të madhësive të qelive në bazë të standardeve të veta (shih paragrafin 21 më poshtë).

Standardet minimale të KPT-së për hapësirë personale të jetesës

9. KPT më 1990 zhvilloi një standard bazë për përmasat minimale të hapësirës së jetesës që një të burgosuri duhet t'i jepet në një qeli.

- 6m² hapësirë jetese për një qelizë me strehim të vetëm
- 4m² hapësirë jetese për çdo të burgosur në një qeli me strehim të shumëfishtë

³ Për shembull, gjatë vizitës së një burgu në Rumani më 1995, KPT-ja ka gjetur se 88 të burgosur mbaheshin në një fjetore me nja 80 m²; në vitin 2009, KPT vizitoi një koloni në Ukrainë, ku një fjetore rreth 200m² ishte e pajisur me 114 shtretër.

⁴ CPT / Inf (2001) 16, paragrafi 29.

⁵ Shih, për shembull, raportin mbi vizitën e vitit 2013 në Greqi, ku është vërejtur një gjendje e tillë në dy burgje (CPT / Inf (2014) 26, paragrafët 105 dhe 106).

⁶ Shih, për shembull, raportin për vizitën e vitit 2009 në Ukrainë (CPT / Inf. (2011) 29, paragrafi 113).

10. Siç e ka bërë të qartë KPT-ja në vitet e fundit, standardi minimal i hapësirës së jetesës duhet të përjashtojë ambientet sanitare brenda një qelie. Rrjedhimisht, një qeli me strehim të vetëm duhet të ketë përmasat 6m² plus hapësira e nevojshme për një aneks sanitar (zakonisht 1m² deri në 2m²). Po ashtu, hapësira e marrë nga aneksi sanitar duhet të përjashtohet nga llogaritja e 4m² për person në një qeli me strehim të shumëfishtë. Më tej, në çdo qelie që akomodon më shumë se një të burgosur, aneksi sanitar duhet të jetë i ndarë plotësisht.

11. Përveç kësaj, KPT-ja konsideron se çdo qeli e përdorur për strehim të të burgosurit duhet të ketë të paktën 2 metra ndërmjet mureve të qelive dhe 2.5 mes dyshemesë dhe tavanit.

Promovimi i standardeve më të larta

12. Rregulla 18.5 e Rregullores Evropiane të Burgjeve (2006) thekson se *"Të burgosurit normalisht do të vendosen gjatë natës nëpër qeli të veçanta, përveç në raste kur është e preferueshme për ata që ta ndajnë ambientin e fjetjes. Në të vërtetë, në shumë vende të Këshillit të Evropës, të burgosurve u jepen qeli teke, shpesh me përmasa mes 7,5m² dhe 9,5m². KPT-ja ka pohuar vazhdimisht se qelitë teke me më pak se 6m² (duke përjashtuar aneksin sanitar) duhen ose të tërhiqen nga shërbimi ose të zgjerohen për të siguruar hapësirë të mjaftueshme të jetesës për një person.*

13. Kur hartoi standardin për 4m² sipërfaqe jetese, KPT-ja kishte marrë parasysh nga njëra anë trendin e vërejtur në një numër të vendeve perëndimore evropiane të dyfishimit të qelive prej 8-9m² të projektuara fillimisht për një person, dhe në anën tjetër ekzistencën e konvikteve me kapaciteteve tejet të mëdha në institucionet e burgjeve (koloni) në vende të ndryshme të Evropës qendrore dhe lindore.

14. Edhe pse KPT-ja nuk ka përcaktuar në mënyrë eksplicite "strehimet e shumëfishta", një analizë e raporteve të vizitës tregon se qelitë për dy deri në katër të burgosur në mënyrë implicite bien nën këtë nocion.⁷ Rrjedhimisht, KPT-ja ka lënë të kuptohet se qelitë me përmasa 8m² ishin të pranueshme për dy të burgosur, qelitë prej 12m² për tre, dhe qelitë 16m² ishin të përshtatshme për katër të burgosur. Megjithatë, në një numër jo të papërfillshëm të rasteve, KPT-ja gjithashtu deklaroi se qelitë me 8m² (ose 8 deri 9m²) duhen "mundësisht" (Sllovenia 2006, Hungaria 2013) ose "idealisht" (Belgjika, 2009) të strehojnë vetëm një të burgosur; ose duhet të "përdoren për të akomoduar jo me shume se një të burgosur me përjashtim të rasteve të veçanta kur do të ishte e pakëshillueshme që një i burgosur të lihej vetëm" (MB, 2003). Në raportin e vizitës së vitit 2011 në Holandë, Komiteti deklaroi se akomodimi në qelitë dyshe me përmasa mes 8 dhe 10m² ishte "jo pa siklet" për të burgosurit, dhe në raportin e vizitës së vitit 2011 në Irlandë, rekomandoi që "duhet të bëhen përpjekje për të shmangur sa më shumë qe te jete e mundur vendosjen e dy të burgosurve në qeli prej 8m²".

⁷ Shih, për shembull, raportin mbi vizitën më 2013 në Poloni (CPT / Inf. (2014) 21, paragrafi 49).

15. Qartazi, shembujt e lartpërmendur tregojnë se standardi me 4m² për të burgosur ende mund të çojë në kushte të strehimit të ngjeshur kur bëhet fjalë për qelitë për një numër të vogël të të burgosurve. Vërtet, duke pasur parasysh se 6m² është sasia minimale e hapësirës së jetesës për t'iu dhënë një të burgosuri të strehuar në një qeli teke, nuk është e vetëkuptueshme se një qeli prej 8m² do të ofrojë hapësirë të kënaqshme të jetesës për dy të burgosur. Sipas mendimit të KPT-së, është e nevojshme që të paktën të bëhet përpjekje për më shumë hapësirë jetese sesa kaq. Standardi prej 4m² është, në fund të fundit, një standard *minimal*.

16. Për këto arsye, KPT-ja ka vendosur të promovojë një standard të *dëshirueshëm* në lidhje me qelitë me strehime të shumëfishta deri në katër të burgosur duke shtuar 4m² për çdo person shtesë për hapësirën minimale të jetesës prej 6m² sipërfaqe për një qeli teke strehimi:

- 2 të burgosur: të paktën 10m² (6m² + 4m²) të hapësirës së jetesës + aneksi sanitar
- 3 të burgosur: të paktën 14m² (6m² + 8m²) të hapësirës së jetesës + aneksi sanitar
- 4 të burgosur: të paktën 18 m² (6m² + 12m²) e hapësirës së jetesës + aneksi sanitar

17. Me fjalë të tjera, do të ishte e dëshirueshme që një qeli prej 8-9m² të mbajë jo më shumë se një të burgosur, dhe një qeli prej 12m² jo më shumë se dy të burgosur.

18. KPT-ja inkurajon gjithë shtetet anëtare të KE t' zbatojnë këto standarde më të larta, veçmas kur ndërtojnë burgjeve të reja.

Standardet minimale kundër trajtimit çnjerëzor e degradues: nevoja për të bërë dallimin

19. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut pranon një numër gjithnjë në rritje të ankesave nga të burgosurit që pretendojnë se po mbahen në kushte çnjerëzore ose degraduese, duke u dashur të ndajnë qelitë me numër të madh të të burgosurve të tjerë, çka u lë atyre shumë pak hapësirë banimi. Gjykata, në vendimet e veta, detyrohet të vendosë nëse mbajtja e të burgosurve në qeli që ofrojnë hapësirë shumë të kufizuar jetese për person (zakonisht më pak se 4m²) përbën një shkelje të nenit 3 të KEDNj-së.

20. Roli i KPT-së, si organ parandalues monitorues, është i ndryshëm. Përgjegjësia e tij nuk nënkupton prononcim nëse një situatë e caktuar përbën trajtim ose dënim çnjerëzor ose poshtërues në kuptim të nenit 3 të KEDNj-së⁸ Megjithatë, gjatë vizitave, Komiteti është ballafaquar me kushtet e burgjeve që imponin besimin dhe ishin, siç është përshkruar në një raport vizitë, "fyerje për një shoqëri të civilizuar". Prandaj, në një numër raportesh të vizitave KPT ka deklaruar se kushtet e vërejtura në burgjet e mbipopulluara rëndshëm mund të konsiderohen si "trajtim çnjerëzor dhe poshtërues".

⁸ Shih për këtë Nenin 17 (2) të Konventës Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimt Çnjerëzor ose Poshtërues (ECPT).

21. KPT-ja kurrë nuk ka konsideruar se standardet e veta për përmasat e qelive duhet të konsiderohet si absolute. Me fjalë të tjera, ajo nuk ka automatikisht pikëpamjen se një devijim i vogël nga standardet e saj minimale në vetvete mund të konsiderohet si trajtim çnjerëzor dhe poshtëruës i të burgosurit përkatës, sa kohë mund të gjenden faktorë të tjerë zbutës, në veçanti fakti se të burgosurit janë në gjendje për të shpenzuar një sasi të konsiderueshme të kohës çdo ditë jashtë qelive të tyre (në punëtori, klasa ose aktivitete të tjera). Megjithatë, edhe në raste të tilla, KPT-ja ende do të rekomandojë që standardi minimal të respektohet.

22. Në anën tjetër, që Komiteti të thotë se kushtet e ndalimit mund të konsiderohen si trajtim çnjerëzor dhe poshtëruës, qelitë ose duhet të jenë jashtëzakonisht të mbipopulluara, ose, si në shumicën e rasteve, të kombinojnë një numër elementesh negative, si numri i pamjaftueshëm i shtretërve për të gjithë të burgosurit, higjiena, infektimi me parazitë, ventilimi i pamjaftueshëm, ngrohja ose ndriçimi, mungesa e higjienës në qeli dhe si pasojë përdorimi i kovave ose shisheve për nevojat fiziologjike. Në fakt, gjasa që një vend i paraburgimit të jetë shumë i mbipopulluar, por në të njëjtën kohë i ventiluar mirë, i pastër dhe i pajisur me një numër të mjaftueshëm të shtretërve është jashtëzakonisht e ulët. Pra, nuk është çudi që shpesh KPT rendit faktorët që përbëjnë kushtet e tmerrshme të paraburgimit, në vend se vetëm t'i referohet hapësirës së pamjaftueshme të jetesës. Përveç kësaj - por në asnjë mënyrë në çdo rast - faktorë të tjerë jo të lidhur drejtpërdrejt me kushtet merren parasysh nga KPT-ja gjatë vlerësimit të një situate të caktuar. Këta faktorë përfshijnë kohën e paktë jashtë qelisë dhe në përgjithësi regjimin e dobët; ushtrimet në natyrë të reduktuara; heqjen e kontakteve me të afërmit për disa vjet, etj.

23. Shtojca e këtij dokumenti përmban një listë joshteruese të faktorëve (përveç përmasave së hapësirës së jetesës për çdo të burgosur) që duhet të merren parasysh gjatë vlerësimit të kushteve të mbajtjes në burg.

Përfundim

24. Ky dokument synon të ofrojë udhëzime për praktikuesit dhe palët e tjera të interesuara, duke theksuar qartazi standardet minimale të KPT-së lidhur me hapësirën e jetesës për të burgosur (a) në një qeli. Përfundimisht, u mbetet gjykatave të vendosin nëse një person i caktuar ka përjetuar vuajtje që ka arritur pragun e trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës brenda kuptimit të nenit 3 të KEDNj-së, duke marrë parasysh të gjitha llojet e faktorëve, përfshirë edhe konstituimin personal të individit. Numri i metrave katror në dispozicion për person është vetëm njëri faktor, edhe pse shpesh shumë i rëndësishëm ose edhe vendimtar.

25. Kushtet ku të burgosurit lihen me më pak se 4m² për person në qeli me strehim të shumëfishtë ose qelitë teke që kanë më pak se 6m² (të dyja me përjashtim të aneksit sanitar) vazhdimisht janë kritikuar nga KPT-ja, dhe autoritetet rregullisht janë thirrur t'i zgjerojnë (ose t'i tërheqin nga shërbimi), qelitë teke ose ta zvogëlojnë numrin e të burgosurve në qeli me strehim të shumëfishtë. KPT-ja pret që këto standarde minimale të hapësirës së jetesës të zbatohen sistematikisht në të gjitha institucionet e burgjeve në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, dhe shpreson se gjithnjë e më shumë vende do të përpiqen t'i përmbushin standardet "e dëshirueshme" KPT për qelitë me strehim të shumëfishtë.

SHTOJCA

Shembuj të faktorëve të tjerë që duhet të merren në konsideratë kur vlerësohen kushtet e paraburgimit në burg

Gjendja e riparimit dhe pastërtisë

- Qelitë, duke përfshirë mobilet, duhet të jetë në një gjendje të rregullt dhe duhet të bëhet çdo përpjekje për t'i mbajtur zonat e jetesës të pastra dhe higjienike.
- Çdo infektim me parazitë duhet të trajtohet me rreptësi.
- Të burgosurit duhet të pajisen me produktet e nevojshme për higjienë personale dhe me materiale pastrimi.

Qasja në dritë natyrore, ventilim dhe ngrohje

- Të gjitha strehimet e jetesës për të burgosurit (edhe në qeli teke edhe në ato të shumëfishta) duhet të kenë qasje në dritë natyrore, si dhe në ndriçim artificial që është i mjaftueshëm për qëllime leximi.
- Po ashtu, duhet të ketë ventilim të mjaftueshëm për të siguruar freskim të vazhdueshëm të ajrit brenda qelive.
- Qelitë duhet të ngrohen mjaftueshëm.

Objektet sanitare

- Çdo qeli duhet të ketë një tualet dhe një lavaman si minimum. Në qelitë me strehim të shumëfishtë aneksi sanitar duhet të jetë i ndarë plotësisht (d.m.th. deri në tavan).
- Në ato pak burgje ku nuk ka në qeli pajisje sanitare në dispozicion, autoritetet duhet të sigurohen që të burgosurit të qasje në tualet kurdo që u nevojitet. Sot, asnjë i burgosur në Evropë nuk duhet të detyrohet të "derdhë ujë jashtë", një praktikë kjo degraduese si për të burgosurit ashtu edhe për anëtarët e stafit që duhet ta mbikëqyrin një procedurë të tillë.

Ushtrimi në ambient të jashtëm

- KPT konsideron se çdo të burgosuri duhet t'i ofrohet një minimum prej një ore në ditë ushtrim jashtë. Oborret e ushtrimit duhet të jenë hapësinore dhe të pajisura përshtatshëm për t'u dhënë të burgosurve një mundësi reale për të ushtruar fizikisht (për shembull, për ushtrimin e sporteve); duhet të jenë të pajisur edhe me një mjet pushimi (p.sh., një bankë) dhe një strehë kundër motit me shi.

Aktivitetet e qëllimshme

- KPT-ja ka rekomanduar kohë të gjatë që të burgosurve t'u ofrohet një sërë e aktiviteteve të qëllimshme (punë, profesion, arsim, sport dhe rekreacion). Për këtë qëllim, KPT-ja ka deklaruar që në vitet 1990 se qëllimi duhet të jetë që të burgosurit - të dënuar dhe të paraburgosur - të shpenzojnë tetë orë ose më shumë në ditë jashtë qelive të tyre të angazhuar në aktivitete të tilla, dhe se për të burgosurit e dënuar regjimi duhet të jetë edhe më i favorshëm.